<p>2.2.mbikëqyr Sistemin në mënyrë të rregullt duke siguruar funksionimin e plotë të Sistemit dhe siguron dhe ndërmerr masat e duhura për vendosjen, përpunimin apo shfrytëzimin e të dhënave.</p> <p>2.3. informoj të gjithë personat e autorizuar, shfrytëzuesit apo operatorët për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë shfrytëzimit të Sistemit</p> <p>2.4.ruaj fshehtësinë e të dhënave konfidenciale apo personale nëse gjatë kryerjes së detyrës qaset në të dhëna të tilla dhe informon personin përgjegjës të entitetit përkatës.</p> <p>2.5. në rast se ndonjëri prej personave përgjegjës shkel të drejtat dhe detyrimet e tij/saj, Administratori ka të drejtë të dërgojë vërejtje me shkrim tek personi i cili ka bërë shkelje si dhe të njoftojë eprorët e tij/saj. Në rast të mospërbushjes të detyrave sipas nenit 9 të kësaj Rregullore, personit përgjegjës mund t'i ndalohet qasja në SIZHEK.</p> <p>3.Institucioni apo entiteti është i obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të caktojë një përfaqësues tjetër, me qëllim të funksionimit të rregullt të Sistemit.</p> <p>4.Çdo ndryshim i përfaqësuesit të institucionit apo entitetit bëhet me miratimin e zyrtarit kryesor administrativ të entitetit përkatës.</p>	<p>2.2.supervises the System on a regular basis ensuring full functioning of System and ensures and takes appropriate measures for placement, processing or use of data.</p> <p>2.3.informs all authorized persons, users or operators of their rights and obligations during the use of the System.</p> <p>2.4.maintains secrecy of confidential or personal data when accessing such data during the performance of the duty and informs the responsible person of the respective entity.</p> <p>2.5.in the event that any of the responsible persons violates his/her rights and obligations, the Administrator has the right to make a written warning to the person who has committed a violation and to notify his or her superiors. In case of non-fulfillment of duties under article 9 of the present Regulation, the responsible person may be denied access to IISEDK.</p> <p>3. The institution or entity shall be obliged to appoint another representative for the purpose of regular functioning of the System within thirty (30) days.</p> <p>4. Any replacement of the representative of the institution or entity shall be done with the approval of the chief administrative officer of the respective entity.</p>	<p>2.2.redovno nadgleda Sistem osiguravajući potpuno funkcionisanje Sistema i osigurava i preduzima potrebne mere za unošenje, obradu ili korišćenje podataka.</p> <p>2.3.pouči sva ovlašćena lica, korisnike ili operatore o njihovim pravima i dužnostima prilikom korišćenja Sistema.</p> <p>2.4. čuva tajnost poverljivih podataka ili ličnih podataka ako prilikom vršenja dužnosti dođe do takvih podataka i o tome izveštava odgovorno lice nadležnog entiteta.</p> <p>2.5. u slučaju da neko od odgovornih lica prekrši svoje pravo ili obaveze, Administrator ima pravo da uputi pismenu opomenu licu koje je počinilo povredu i da o tome izvesti svoje pretpostavljene. U slučaju neispunjavanja obaveza prema članu 9 ovog pravilnika, odgovornom licu se može zabraniti pristup u IISERK.</p> <p>3.Institucija ili entitet su dužni da u roku od trideset (30) dana odrede drugog predstavnika u cilju redovnog funkcionisanja sistema.</p> <p>4. Svaka promena predstavnika institucija ili entiteta se vrši uz odobrenje glavnog administrativnog službenika relevantnog entiteta.</p>
---	---	---

<p>5. Të drejtat e qasjes për grupet e shfrytëzuesve dhe për llogaritë e shfrytëzuesve përcaktohen në mënyrë dinamike. Të drejtat do të përcaktohen në nivel grupi, tabele edhe nivel rekordi, qasje e veçantë.</p> <p>6. Shfrytëzuesit dhe operatorët tjerë kontraktuesit apo nën-kontraktuesit kanë të drejtë të shfrytëzimit të të dhënave për përmbushjen e detyrave e tyre. Për shfrytëzimin e këtyre të drejtave duhet kërkuar me shkrim nga Administratori qasje në Sistem, duke shpjeguar natyrën dhe arsyen e kërkesës. Administratori është i obliguar të jap përgjigje në kërkesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune me shpjegimet e nevojshme.</p>	<p>5. Access rights for user groups and user accounts are determined in a dynamic manner. Rights will be determined at group, table and record level, separate approach.</p> <p>6. Users and other operators (contractors or subcontractors) shall have the right to use the data to fulfill their obligations. For the use of these rights, a written request should be submitted to the Administrator, explaining the nature and purpose of the request. The administrator shall be obliged to reply to the request within a period of fifteen (15) working days with the necessary explanations.</p>	<p>5. Pravo pristupa korisničkim grupama i za račun korisničkih grupa utvrđuju se dinamički. Prava će biti određena na nivou grupa, tabela i nivoa rekorda, poseban pristup).</p> <p>6. Korisnici ili drugi operatori (izvođači ili podizvođači) imaju pravo da koriste podatke za obavljanje svojih poslova. Za korišćenje ovih prava od Administratora se mora zatražiti pristup Sistemu pismenim putem, objašnjavajući prirodu i razlog tog zahteva. Administrator je dužan da odgovori na zahtev u roku od petnaest radnih (15) dana uz potrebna objašnjenja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Detyrat e institucioneve dhe entiteteve të përfshira në SIIZHEK</b></p> <p>1. Çdo institucion apo entitet duhet të caktojë një person përgjegjës për vendosjen dhe editimin e të dhënave në SIIZHEK, në afat prej tridhjetë (30) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore. Për çdo ndryshim të personit përgjegjës, Ministria njoftohet paraprakisht me shkrim nga institucionet dhe entitetet në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë para ndërrimit.</p> <p>2. Personi përgjegjës do të ngarkojë të dhënat e institucionit apo entitetit sipas mënyrave si në vijim:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Duties of institutions and entities involved in IISEDK</b></p> <p>1. Each institution or entity must designate a person responsible for placement and editing data at IISEDK, within thirty (30) days after the entry into force of the present Regulation. The Ministry shall be notified in writing by institutions and entities for any replacement of the responsible person, fifteen (15) days prior to the replacement.</p> <p>2. The responsible person will upload the data of the institution or entity in the following ways:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Dužnosti institucija i entiteta uključenih u IISERK</b></p> <p>1. Svaka institucija ili entitet mora odrediti lice koje je odgovorno za unošenje i uređivanje podataka u IISERK, u roku od trideset (30) dana nakon stupanja na snagu ovog Pravilnika. Za svaku promenu odgovornog lica, Ministarstvo se prethodno obaveštava pismeno od strane institucija i entiteta u roku od petnaest (15) dana pre izmene.</p> <p>2. Odgovorno lice će učitati podatke institucije ili entiteta na sledeći način:</p>

<p>2.1.përmes prototipit të parë ku të dhënat do të merren automatikisht nga API.</p> <p>2.2.përmes prototipit të dytë ku do të përcaktohet shablloni dhe i njëjti do të përdoret për plotësim dhe ngarkim në sistem në periudhat kohore të parapara nga institucionet apo entitetet përgjegjëse.</p> <p>3.Personi përgjegjës para vendosjes dhe editimit të të dhënave në SIZHEK verifikon saktësinë e këtyre të dhënave të ofruara.</p> <p>4.Personi përgjegjës ka të drejtë të ndryshimit të të dhënave të institucionit apo entitetit kur vihet në dijeni se ato të dhëna nuk janë të sakta, të plota ose janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Për çdo vonesë në raportim prej më shumë së tridhjetë (30) dite pune, duhet të informohet me shkrim Administratori i Sistemit, duke dhënë arsyet e vonesës si dhe afatin prej pesëmbdhjetë (15) ditë pune për përmbushjen e kërkesës për raportim. Në rast se personi përgjegjës nga institucioni dhe entiteti tjetër refuzon të përmbush detyrat e përcaktuara në këtë nen, Administratori i Sistemit do të njoftojë me shkrim udhëheqësin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës.</p> <p>6.Në rast të ndërrimit të sistemeve të brendshme të institucioneve apo entiteteve tjera gjatë të cilit vjen tek ndërprerja e</p>	<p>2.1.through the first prototype where the data will be automatically taken from the API.</p> <p>2.2. through the second prototype where the template will be defined and it will be used for filling and loading data in the system in the foreseen time periods by the responsible institutions or entities.</p> <p>3.The responsible person before deciding and editing the data at IISEDK verifies the accuracy of these data provided. will</p> <p>4.The responsible person shall have the right to modify the data of the institution or entity when it becomes known that those data are inaccurate, incomplete or in contradiction with the applicable Laws.</p> <p>5.System Administrator shall be informed in writing for any delay in reporting for more than thirty (30) working days, giving the reasons for the delay and the deadline of fifteen (15) working days for meeting the reporting requirement. In the event the responsible person from the institution and the other entity refuses to perform duties set out in the present Article, the System Administrator shall notify the direct supervisor of the responsible person in writing.</p> <p>6. In case of change of internal systems of institutions or other entities during which the operation of link with IISEDK is cut, the</p>	<p>2.1. putem prvog prototipa gde će se podaci automatski preuzeti sa API-ja.</p> <p>2.2. putem drugog prototipa gde će se odrediti šablon i isti će se koristiti za dopunu i ubacivanje u sistem u predviđenim vremenskim periodima predviđenim od strane nadležnih institucija ili entiteta.</p> <p>3. Odgovorno lice pre odlučivanja i uređivanja podataka u IISERK verifikuje tačnost ovih podataka.</p> <p>4. Odgovorno lice ima pravo na izmenu podataka institucije ili entiteta kada se uoči da ti podaci nisu tačni, potpuni ili su u suprotnosti sa važećim Zakonima na snazi.</p> <p>5. Za svako kašnjenje u izveštavanju više od trideset (30) radnih dana, mora se obavestiti pismenim putem Administrator sistema, navodeći razloge za kašnjenje kao i rok od petnaest (15) radnih dana za ispunjavanje zahteva za izveštavanje. U slučaju da odgovorno lice institucije ili drugog entiteta odbije da ispuni dužnosti utvrđene ovim članom, Administrator sistema će o tome pismeno obavestiti neposrednog rukovodioca odgovornog lica.</p> <p>6.U slučaju promene internih sistema institucija ili drugih entiteta prilikom čega dolazi do prekida veza sa IISERK,</p>
--	---	--

<p>funksionimit të lidhjes me SIIZHEK, personi përgjegjës nga institucioni përkatës ka të drejtë që përmes kërkesës drejtuar Administratorit të SIIZHEK-ut, të kërkojë afat shtesë prej tridhjetë (30) dite pune për rifunksionalizimin dhe ndërlidhjen e Sistemeve.</p> <p>7. Në rastet kur një institucion apo entitet më shumë se dy(2) herë dështon në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me këtë Rregullore, Administratori do t'i njoftojë me shkrim zyrtarët më të lartë administrativ të Ministrisë, institucionet dhe entitetet tjera përkatëse.</p> <p>8. Sigurimi i ngarkimit, përpunimit dhe shfrytëzimit të të dhënave bëhet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>responsible person from the the relevant institution shall be entitled to request an additional deadline of thirty (30) working days by submitting a request to the Administrator of IISEDK for making the system operational and interconnecting Systems.</p> <p>7. In cases where an institution or entity fails to fulfill its duties and responsibilities set out in this Regulation for more than twice, the Administrator shall notify the highest administrative officials of the Ministry, the institutions and other relevant entities in writing.</p> <p>8.The security of uploading, processing and use of data shall be done in accordance with the Law on Personal Data Protection and relevant legislation in force.</p>	<p>odgovorno lice u relevantna institucija ima pravo da putem zahteva upućenog administratoru IISERK, zatraži dodatni rok od trideset (30) radnih dana za ponovno stavljanje u funkciju i povezivanje sistema.</p> <p>7. U slučajevima kada neka institucija ili entitet više od dva (2) puta ne uspe da ispuni obaveze i odgovornosti koje su utvrđene ovim Pravilnikom, Administrator će o tome pismeno obavestiti najviše administrativne rukovodioce ministarstva, institucije i drugog relevantnog entiteta.</p> <p>8. Obezbeđenje unošenja, obrade i korišćenje podataka se vrši u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka i relevantno zakonodavstvo na snazi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Vendosja e të dhënave dhe afatet kohore</b></p> <p>1.Institucionet dhe entitetet e përfshira në SIIZHEK paraqesin të dhënat e tyre, përmes mënyrave të përcaktuara si në vijim:</p> <p>1.1.ngarkimi i të dhënave përmes prototipit API.</p> <p>1.2.ngarkimi i të dhënave direkt në aplikacion, përmes formës së zhvilluar për secilin institucion që nuk mund të ofrojnë të dhëna sipas mënyrës së paraparë në paragrafin 1.1. të këtij neni.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Entry of data and deadlines</b></p> <p>1.Institutions and entities involved in IISEDK shall enter their data in manners determined hereunder;</p> <p>1.1 uploading data through prototype API.</p> <p>1.2 uploading directly to the application through a form developed for each institution that cannot provide data in the manner provided for in paragraph 1.1.of this article.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Unošenje podataka i vremenski rokovi</b></p> <p>1.Institucije i entiteti uključeni u IISERK predstavljaju svoje podatke na sledeći utvrđen način:</p> <p>1.1. učitanje podataka preko prototipa API.</p> <p>1.2. učitanje podataka direktno na aplikaciju putem oblika razvijenog za svaku instituciju koja ne može pružiti podatke na način predviđen u stavu 1.1. ovog člana.</p>



<p>2.Ministria e siguron web aplikacionin e Sistemit në të cilin secili institucion apo entitet do të ketë përdorues të autorizuar.</p> <p>3.Për çdo ngarkim të të dhënave nëpërmjet web aplikacionit, do të krijohet një histori e futjes së të dhënave.</p> <p>4.Të dhënat e ngarkuara në web aplikacion, kontrollohen nga Administratori para se të publikohen.</p> <p>5.Institucionet dhe entitetet kanë të drejtë të ndryshimit të shpeshtësisë së vendosjes së të dhënave, duke e njoftuar Ministrinë lidhur me ndryshim.</p>	<p>2.The Ministry shall provide the System web application in which each institution or entity will have its authorized users.</p> <p>3.For each upload of data through the web application, a history of data entry will be created.</p> <p>4.Data uploaded to the web application is checked by the Administrator before being published.</p> <p>5.Institutions and entities shall have the right to change the frequency of data entry, by notifying the Ministry about the change.</p>	<p>2. Ministarstvo obezbeđuje web aplikaciju sistema u kojem će svaka institucija ili entitet imati ovlašćenog korisnika.</p> <p>3. Za svako učitavanje podataka putem web aplikacije biće kreirana istorija unosa podataka.</p> <p>4. Podaci učitani u web aplikaciju se kontrolišu od strane Administratora pre objavljivanja.</p> <p>5. Institucije i entiteti imaju pravo na izmenu učestalosti unosa podataka, obaveštavajući ministarstvo o ovoj izmeni.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Konfidencialiteti i të dhënave</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Confidentiality of data</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Poverljivost podataka</b></p>
<p>1. Konfidencialiteti, saktësia, besueshmëria dhe paraqitja e të dhënave në web aplikacion është në përgjegjësinë e institucionit apo entitetit përkatës.</p> <p>2. Personi përgjegjës apo i autorizuar nga institucionet dhe entitetet, nuk do të lejojë qasje, të shpalosë apo publikojë informacionin konfidencial që ai/ajo ka marrë gjatë realizimit të punës, të përdorë apo të lejojë këtë informacion të përdoret për përfitim personal.</p> <p>3.Institucionet dhe entitetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme administrative dhe teknike për të siguruar</p>	<p>1.Confidentiality, accuracy, reliability and entry of data in the web application shall be the responsibility of each respective institution or entity.</p> <p>2.The responsible person or a person authorized by institutions and entities will not allow access, disclosure or publication of confidential information that he or she received during the discharge of duty, to be used or allow such information to be used for personal gains.</p> <p>3.Institutions and entities should undertake all necessary administrative and technical</p>	<p>1. Poverljivost, tačnost, pouzdanost i prikazivanje podataka u web aplikaciji su odgovornost institucije ili relevantnog entiteta.</p> <p>2. Odgovorno lice ili lice koje je ovlastila institucija ili entitet, neće dozvoliti pristup, otkrivanje ili objavljivanje poverljivih informacije koje je ono dobilo tokom obavljanja posla, niti će koristi ili dozvoli da se ova informacija koristi za lični interes.</p> <p>3. Institucije ili entiteti će preduzeti sve neophodne administrativne i tehničke mere</p>

<p>mbrojtjen fizike dhe elektronike e të dhënave konfidenciale.</p> <p>4. Të gjithë personat përgjegjës sipas paragrafit 2 të këtij neni, personat e autorizuar sipas nenit 8 paragrafi 2, shfrytëzuesit apo operatorët janë të obliguar që gjatë kryerjes së punëve të mbrojnë fshehtësinë e të dhënave personale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>5. Në rast se ndonjëri prej personave të autorizuar, shfrytëzuesit apo operatorët tjerë gjatë kryerjes së punës së tyre hasin në të dhëna të cilat mund të konsiderohen personale apo konfidenciale, ata janë të obliguar që të sigurojnë mbrojtjen e tyre dhe apo të lajmërojnë administratorin e Sistemit jo më vonë se tri (3) ditë pas evidentimit të të dhënave të tilla.</p> <p>6. Në rast të shkeljes së dispozitave për sigurinë e të dhënave personale apo konfidenciale, zbatohen dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Veçoritë e cilësisë së të dhënave</b></p> <p>1. Institucionet apo entitetet tjera përkatëse do të sigurojnë cilësinë e të dhënave të</p>	<p>measures to ensure the physical and electronic protection of confidential data.</p> <p>4. All persons responsible under paragraph 2 of this Article, persons authorized under article 8 par 2, users or operators shall be obliged to protect confidentiality of personal data during the performance of their duties in accordance with the Law on protection of personal data and other applicable legislation</p> <p>5. If any of the authorized persons, users or other operators in their work, encounter data that can be considered personal or confidential, such person shall be obligated to ensure their protection if authorized and/or notify the administrator of the System no later than three(3) days after evidencing such data.</p> <p>6. In case of violation of the provisions the Law on Personal Data Protection and other applicable legislation shall apply for violations of provisions on the security of personal or confidential data.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Data quality features</b></p> <p>1. Institutions or other relevant entities will ensure the quality of uploaded data which</p>	<p>za obezbeđivanje fizičke i elektronske zaštite poverljivih podataka.</p> <p>4. Sva lica koja su odgovorna prema stavu 2 ovog člana, lica ovlašćena prema članu 8 stav 2, korisnici ili operatori su dužni da tokom izvršavanja poslova štite poverljivost ličnih podataka u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka kao i drugim važećim zakonodavstvom.</p> <p>5. U slučaju da neko od ovlašćenih lica, korisnika ili drugi operatori tokom obavljanja posla naiđu na podatke koji mogu da se smatraju kao lični ili poverljivi, to lice je dužno da osigura zaštitu tih podataka ako je ovlašćeno ili da o tome obavesti administratora sistema najkasnije tri (3) dana nakon uočavanja takvih podataka.</p> <p>6. U slučaju kršenja povrede odredaba za obezbeđivanje ličnih ili poverljivih podataka, primenjuju se odredbe Zakona o zaštiti ličnih podataka i odredbe važećeg zakonodavstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Karakteristike kvaliteta podataka</b></p> <p>1. Institucije ili drugi relevantni entiteti će obezbediti kvalitet učitanih podataka koji se</p>
---	---	--

<p>ngarkuara të cilat integrohen në Sistem, duke aplikuar veçoritë si në vijim:</p> <p>1.1.Relevanca i referohet nivelit të cilin të dhënat e ngarkuara përmbushin nevojat aktuale dhe potenciale të shfrytëzuesve. Të dhënat ngarkuara duhet të verifikohen nga vetë institucioni përgjegjës para integritit të e tyre në SIIZHEK.</p> <p>1.2.Saktësia i referohet sigurimit se të dhënat nuk janë ndryshuar nga origjina e tyre në mënyrë të paautorizuar, duke ruajtur saktësinë dhe plotësinë e tyre.</p> <p>1.3.Besueshmëria, i referohet metodave dhe procedurave lidhur me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave të përcaktuara sipas standardeve profesionale dhe metodave shkencore.</p> <p>1.4.Afati kohor i referohet vonesës mes datës së lëshimit të të dhënave dhe datës së synuar kur të dhënat duhet të ngarkohen në SIIZHEK.</p> <p>1.5. Objektiviteti nënkupton se të dhënat duhet të prodhohen dhe ngarkohen në mënyrë të besueshme dhe të paanshme, sipas standardeve profesionale dhe etike.</p> <p>1.6.Disponueshmëria e të dhënave, të cilat do të jenë në dispozicion për shfrytëzuesit e autorizuar, përderisa ato të dhëna nuk konsiderohen konfidenciale.</p>	<p>are integrated to the System, by applying the following features:</p> <p>1.1. Relevance refers to the level at which the uploaded data fulfill the actual and potential needs of users. The uploaded data must be verified by the responsible institution before their integration into IISEDK.</p> <p>1.2. Accuracy refers to ensuring that data is not altered in an unauthorized manner from their origin, while maintaining their accuracy and completeness.</p> <p>1.3. Reliability refers to methods and procedures related to the collection, processing and publication of data determined by professional standards and scientific methods.</p> <p>1.4. The time line refers to the delay between the date of release of data and the target date when the data should be uploaded to IISEDK.</p> <p>1.5. Objectivity implies that data must be produced and uploaded in a reliable and impartial manner, according to professional and ethical standards.</p> <p>1.6. Availability means data that will be available to authorized users, for as long as those data are not considered confidential.</p>	<p>integrišu u sistem, koristeći sledeće karakteristike:</p> <p>1.1. Relevantnost se odnosi na nivo na koji učitani podaci zadovoljavaju trenutne i potencijalne povrede korisnika. Učitani podaci se moraju proveriti od strane same nadležne institucije pre njihove integracije u IISERK.</p> <p>1.2. Tačnost se odnosi na osiguravanje da podaci nisu izmenjeni od originalnih na neovlašćen način, čuvajući njihovu tačnost i potpunost.</p> <p>1.3. Pouzdanost se odnosi na metode i postupke u vezi prikupljanja, obrade i objavljivanja podataka utvrđenih na osnovu profesionalnih standarda i naučnih metoda.</p> <p>1.4. Vremenski rok se odnosi na kašnjenje između dana objavljivanja podataka i dana kada se očekuje da podaci treba da budu učitani u IISERK.</p> <p>1.5. Objektivnost podrazumeva podatke koje treba proizvesti i učitati na pouzdan i nepristrasan način, prema profesionalnim i etičkim standardima.</p> <p>1.6. Dostupnost podrazumeva podatke koji će biti dostupni ovlašćenim korisnicima, sve dok se takvi podaci ne smatraju poverljivim.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Disponueshmëria e të dhënave</b></p> <p>1. Secili shfrytëzues do të mund të shohë, lexojë të dhënat e publikuara nga institucionet dhe entitetet tjera, nëse ato nuk janë të ndaluara me ndonjë akt të veçantë ligjor. Të dhënat do të ngarkohen në SIIZHEK për të siguruar qasje të barabartë në të dhënat publike dhe sipas parimit të paanësisë.</p> <p>2. Të dhënat që eventualisht mund të jenë me qasje të kufizuar do të mbesin të tilla edhe në sistem, përmes menaxhimit të administrimit të sistemit.</p> <p>3. E drejta e qasjes në të dhëna të plota për qëllime shkencore apo hulumtuese bëhet përmes kërkesës me shkrim drejtuar institucionit përgjegjës për prodhimin e të dhënave.</p> <p>4. Institucioni të cilit i është drejtuar kërkesa për qasje në të dhëna është i obliguar të jap përgjigje në kërkesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Availability of data</b></p> <p>1. Each user will be able to see, read the data published by institutions and other entities if they are not prohibited by any specific legal act. The data will be uploaded to IISEDK to ensure equal access to public records and based on the principle of impartiality.</p> <p>2. Data that eventually may be of limited access will remain in the system, through management of the system administration.</p> <p>3. The right of access to full data for scientific or research purposes is done through a written request addressed to the institution responsible for data production.</p> <p>4. The institution to which the request for access to data is addressed shall be obliged to give a response to the request within fifteen (15) working days.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Dostupnost informacija</b></p> <p>1. Svaki korisnik će moći da ima uvid, pročita objavljene podatke od strane institucija i drugih entiteta, ako one nisu zabranjene nekakvim posebnim pravnim aktom. Podaci će biti učitanu u IISERK kako bi se obezbedio jednak pristup objavljenim podacima i na osnovu nepristrasnog principa.</p> <p>2. Podaci koji eventualno mogu imati ograničen pristup ostaće takvi i u Sistemu, putem upravljanja administracije sistema.</p> <p>3. Pravo pristupa potpunog pristupa podacima u naučne ili istraživačke svrhe se vrši na osnovu pismenog zahteva dostavljenog nadležnoj instituciji za proizvodnju podataka.</p> <p>4. Institucija kojoj je upućen zahtev za pristup podacima je dužna da odgovori na zahtev u roku od petnaest (15) radnih dana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Përdorimi i të dhënave nga institucionet dhe entitetet</b></p> <p>1. Institucionet dhe entitetet bëjnë përpunimin dhe analizën e të dhënave, të cilat shërbejnë për:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Use of data by institutions and entities</b></p> <p>1. Institutions and entities perform data processing and analysis, which serve for:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Korišćenje podataka od strane institucije i entiteta</b></p> <p>1. Institucije i entiteti vrše obradu i analizu podataka koji služe za:</p>

<p>1.1. Monitorimin dhe përpunimin e vazhdueshëm të indikatorëve dhe të dhënave mbi zhvillimin ekonomik;</p> <p>1.2. Nxjerrjen e përfundimeve të nevojshme për analizën e situatës dhe trendeve të zhvillimit të ekonomisë vendore;</p> <p>1.3. Publikimin e raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesore të zhvillimit sektorial apo të ekonomisë.</p>	<p>1.1. Continuous monitoring and processing of indicators and data on economic development;</p> <p>1.2. Generating necessary conclusions for analysis of situation and trends of national economy development;</p> <p>1.3. Publication of periodic reports that highlight the main indicators of sectoral or economic development.</p>	<p>1.1. Kontinuirano praćenje indikatora i podataka o ekonomskom razvoju;</p> <p>1.2. Donošenje neophodnih zaključaka o analizi situacije i trendova razvoja domaće ekonomije;</p> <p>1.3. Objavljivanje neophodnih periodičnih izveštaja koji ističu glavne indikatore sektorskog ili ekonomskog razvoja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Vërtetësia e të dhënave</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Data accuracy</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Tačnost podataka</b></p>
<p>1. Secili institucion dhe entitet është përgjegjës për ngarkimin dhe modifikimin e të dhënave të tyre. Institucionet dhe entitetet tjera janë të obliguara të japin informata të sakta dhe të përditësuara për shfrytëzuesit e Sistemit.</p> <p>2. Secili person përgjegjës për ngarkimin e të dhënave është i obliguar që gjatë procesit të ngarkimit të të dhënave në SIIZHEK të përcakton burimin e të dhënave dhe institucionin apo entitetin që ka përgatitur të dhënat apo raportin.</p>	<p>1. Each institution and entity shall be responsible for uploading and modifying their data. Institutions and other entities are obliged to provide accurate and up-to-date information to System users.</p> <p>2. During the process of data upload at IISEDKE each person responsible for uploading data shall be obliged to determine the source of the data and the institution or entity that prepared data or report.</p>	<p>1. Svaka institucija ili entitet su odgovorni za učitavanje i modifikovanje svojih podataka. Institucije i drugi entiteti su dužni da pruže tačne i ažurirane informacije o korisnicima sistema.</p> <p>2. Svako odgovorno lice za učitavanje podataka je dužno da tokom procesa učitavanja podataka u IISERK utvrdi izvor podataka i instituciju i entitet koji je pripremio podatke ili izveštaj.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Mbikëqyrja</b></p> <p>Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregullore është Ministria.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Oversight</b></p> <p>The responsible institution for overseeing</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Nadgledanje</b></p> <p>Za nadgledanje sprovođenja ovog Pravilnika odgovorno je Ministarstvo.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 17 Raportimi</b></p> <p>1. Administratori, harton raport në baza të rregullta tremujore, i cili përmban:</p> <p>1.1. funksionimin e SIIZHEK-ut, si dhe propozimin e masave të nevojshme në rast të pengesave në funksionim të Sistemit;</p> <p>1.2. përmbushjen e obligimeve nga institucionet dhe entitetet përkatëse në zbatim të kësaj Rregullore si dhe përditësimin e të dhënave të tyre.</p> <p>2. Sipas nevojës, raporti i dërgohet Qeverisë përmes Ministrit.</p>	<p>the implementation of this Regulation shall be the Ministry.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17 Reporting</b></p> <p>1. The Administrator compiles a regular quarterly report, which contains:</p> <p>1.1 functioning of the IISEDKE as well as the proposal of the necessary measures in the event of system interferences</p> <p>1.2. compliance with the obligations of the respective institutions and entities pursuant to this Regulation and updating their data.</p> <p>2. If necessary, the report shall be sent to the Government through the Minister.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17 izveštavanje</b></p> <p>1. Administrator sastavlja redovne kvartalne izveštaje koji sadrže:</p> <p>1.1 funkcionisanje IISERK, kao i predlog neophodnih mera u slučaju intervencije u Sistem;</p> <p>1.2. ispunjavanje obaveza odgovarajućih institucija i entiteta u primjeni ove Uredbe i ažuriranje njihovih podataka.</p> <p>2. Ako je potrebno, izvještaj se šalje Vladi preko ministra</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 18 Shfuqizimi</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Vendimi Nr.09/115 i datës 13.02.2013 për themelimin e Grupit Punues për menaxhimin e projektit Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik, si dhe Vendimi Nr.04/170 datë 14.02.2014 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr.09/115 të datës 13.02.2013.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 18 Repeal</b></p> <p>Upon the entry into force of this Regulation, the Decision shall be repealed No. 09/115 dated 13.02.2013 on the Establishment of the Project Management Group for the Integrated Information System for Economic Development, as well as Decision No.04/170, dated 14.02.2014, is hereby repealed and amending the Decision No. 09/115 of 13.02.2013.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 18 Ukidanje</b></p> <p>Nakon stupanja na snagu ove Uredbe, Odlukom Br. 09/115 od 13.02.2013. godine o osnivanju Grupe za upravljanje projektom za Integrisani informacioni sistem za ekonomski razvoj i Odluke br. 04/170 od 14.02.2014. godine, ovim se ukida i izmjenama Odluke broj 09/115 od 13.02.2013.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Ramush Haradinaj</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Kryeministër i Republikës së Kosovës</b></p> <p style="text-align: right;">12 / dhjetor/ 2018</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Entry into force</b></p> <p>This Regulation shall enter into force seven (7) days after its signature by the Prime Minister of the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Ramush Haradinaj</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Prime Minister of the Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: right;">12/ December/ 2018</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj uredba ulazi na snazi sedam (7) dana, nakon potpisivanja od Premijera Vlade Republike Kosova.</p> <p style="text-align: right;">Ramush Haradinaj</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Premijer Republike Kosova</b></p> <p style="text-align: right;">12/ decembar/ 2018</p>
--	--	---